

RENDI FAMILJAR NE ISLAM



nga Shejkh Muhamed Aman el-Xhami



Përmbajtja

Disa fjalë rreth autori	fq.4
Hyrje	fq.11
Qëllimi i martesës në Islam	fq.18
Kush e merr përsipër drejtimin e institucionit të familjes	fq.21
Përgjegjësia e gruas në Islam	fq.25
Islami nuk i bën padrejtësi gruas	fq.26
Gruaja në Islam gëzon të njëjtat të drejta civile sikurse burri	fq.28
Të drejtat fetare të gruas Muslimane	fq.29
Liria e gruas Muslimane për t'u martuar	fq.30
Trashëgimia e gruas në Islam	fq.31
Udhëtimi i gruas në Islam	fq.33
Qëndrimi i Islamit ndaj zbulimit të gruas, përzierjes dhe izolimit (të gruas me burrin e huaj)	fq.35
Qëndrimi i Islamit ndaj punës së gruas	fq.37
Fundi i jetës bashkëshortore	fq.40
Përse Islami e ka lënë divorcin në dorën e burrit	fq.43

Disa fjalë rreth autorit

Ai është dijetari i madh, shërbëtori i Sunetit dhe Akijdes Selefije, Muhamed Ibn Aman Ibn ‘Ali el-Xhamij, Allahu pastë mëshirë për të. Lindi në vitin 1349 Hixhrij (1927 E.K.), sikurse tregohet në dokumentat e tij zyrtare. U rrit në një fshat me emrin Tuga Tab në Habesh (Etiopi), aty ku studioi edhe Kur’anin Fisnik. Pasi e përfundoi mësimin e Kur’anit, ai filloi të studjojë librat e Fik’hut të medh’hebit Shafi’i. Në këtë fshat ai studjoi gjithashtu gjuhën Arabe me Shejkh Muhamed Amin el-Hurari. Më pas u largua nga fshati i tij për të shkuar në një fshat tjetër, ku takoi një tjetër student, Shejkh ‘Abdul-Kerim, me të cilin më vonë do të bënte hixhret për në Arabinë Saudite. Pastaj të dy vazhduan të merrnin mësim tek Shejkh Musa, me të cilin studjuan veprën *Nadhmuz-Zuhd* të Ibn Raslan, dhe pastaj studiuan *Metnul-Minhaxh* me Shejkh Abadir, përfshi edhe shumë fusha të tjera të dijes.

Ai kishte dëshirë që të udhëtonte për në Tokën e Shenjtë të Mekkes për të kërkuar dije dhe për të kryer haxhin, kështu që të dy studentët u larguan nga Habeshi (Etiopia) dhe udhëtuan drejt Somalisë. Aty hipën në një anije që shkonte në Aden, Jemen, dhe gjatë kësaj kohe ata u përballën me shumë vështirësi qoftë në det apo në tokë. Udhëtuan në këmbë, dhe në këtë gjendje agjëruan edhe Muajin e Ramazanit, derisa mbërritën në Arabinë Saudite.

Kaluan në Samitah, Subija dhe Ebij Arijsh, derisa u lejuan që të hynin në Mekke, gjithnjë duke udhëtuar në këmbë.

Pasi kreu haxhin më 1369 Hixhrij, ai filloi të kërkojë dije në mexhliset e dijes që mbaheshin në Mesxhidul-Haram, prej tyre: mexhliset e Shejkh ‘Abdu-Rrazak Hamzah, Allahu e mëshiroftë, Shejkh ‘Abdul-Hak el-Hashimij, Allahu e mëshiroftë, Shejkh Muhamed ‘Abdullah es-Sumalij... etj.

Ai u njoh me Shejkh ‘Abdul-‘Aziz Ibn Baz ndërkohë që ishte në Mekke, ku më pas e shoqëroi atë në udhëtimin e tij për në Rrijad kur u hap Instituti i Rrijadit. Kjo ka ndodhur në fillim të vitit 1370 Hixhrij (1970 E.K.).

Gjatë kohës që Shejkh Muhamed Aman el-Xhamij studjonte në Institut, ai u shoqërua me dijetarin e nderuar ‘Abdul-Muhsin el-‘Abbad el-Bedr dhe Shejkhun e nderuar ‘Ali Ibn Mahna, i cili më vonë do të bëhej gjykatës në Gjykatën e Lartë të Sheriatit në Medine.

Ai mori pjesë në shumë mexhlise të dijes gjatë kohës që ishte në Rrijad.

Ai përfitoi dhe pati ndikim të madh nga shkëlqesia e tij, Myftiu, Fekijhu, Shejkh Muhamed Ibn Ibrahim Aali-Shejkh, Allahu e mëshiroftë.

Gjithashtu ai u ngjit pas Shejkhut të nderuar ‘Abdu-Rrahman el-Afriki, Allahu e mëshiroftë, ashtu sikurse veproi edhe me shkëlqesinë e tij, Shejkh ‘Abdul-‘Aziz Ibn Baz, duke përfutur shumë nga dija e gjerë dhe sjelljet fisnike të Shejkhut. Po ashtu, gjatë kohës që ishte në Rrijad, ai përfitoi nga Shejkhun i nderuar Muhamed el-Emin el-Xheknij esh-Shenkijti, Allahu e mëshiroftë, dhe nga Shejkhun i nderuar, Muhadithi Hammad el-Ensari, Allahu e mëshiroftë, dhe nga Shejkhun i nderuar ‘Abdu-Rrazak el-Afijfi, dhe u ndikua shumë nga metoda e tij në mësimdhënie. Po kështu, ai ishte nën ndikimin e Shejkhut të nderuar ‘Abdu-Rrahman es-Sa’dij, Allahu e mëshiroftë, me të cilin edhe pse nuk studioi, mbante korrespondencë nëpërmjet letrave. Ai studioi gjithashtu me Shejkhun e nderuar Muhamed Khalil Harras, Allahu e mëshiroftë, dhe me Shejkhun e nderuar ‘Abdullah el-Kara’uij, Allahu e mëshiroftë.

Pasi u diplomua në Institutin e Rrijadit, ai vazhdoi më tej në Fakultetin e Sheriatit, ku u diplomua në vitin 1380 Hixhrij. Pastaj mori gradën master në Sheriat nga Universiteti i Punxhabit në vitin 1974 (E.K.), dhe pastaj Doktoraturën në *Darul-Ulum* në Kajro.

Shejkh u arriti një pozitë të lartë mes njerëzve të dijes pasi ai ishte orator dhe shumë i besueshëm, aq sa Shejkh Ibni Bazi ndërmjetësoi personalisht tek Shejkh Muhamed Ibrahim (Aali-Shejkh) që ta caktonte atë si mësues në Institutin e Samitas, në krahinën e Xhezanit. Për më tepër, një fakt tjetër që dëshmon dijen e tij të gjerë dhe Akijden e tij dhe respektin që gëzonte ai mes njerëzve të dijes është se kur u hap Universiteti Islamik i Medines, ai u transferua atje për të dhënë mësim, pasiqë u përzgjodh nga Shejkh Ibni Bazi.

Dihet që Universiteti Islamik i Medines u ngrit që të përhapte Akijden e saktë të Selefëve tanë të Mirë dhe Universiteti e caktoi Shejkhun në detyrën e mësuesit të Akijdes dhe më vonë në Fakultetin e Sheriatit, për shkak të dijes së tij të fuqishme në Akijde.

Me vdekjen e tij, Shejkh Ibni Bazi ka thënë:

“Ai është i njohur tek unë si njeri me dije, me virtyte dhe me Akijde të saktë, energjik në Thirrjen për tek Allahu i Përsosur nga çdo e metë, si dhe në paralajmërimin kundër bidateve dhe bestytnive. Allahu e faltë dhe e bëftë banor të Xheneteve të Tij të gjera, i përmirësoftë pasardhësit e tij dhe na bashkoftë neve dhe juve në Tokën e Tij të Nderit (Xhenet). Vërtet, Ai është Gjithëdhëgues dhe i Afërt (me Dijen dhe Fuqinë e Tij).” 1/9/1418 Hixhrij.

Shejkh ‘Abdul-Muhsin el-‘Abbad el-Bedr ka thënë:

“E kam njohur Shejkhun Muhamed Aman Ibn Ali el-Xhamij si student në Institutin në Rrijad, pastaj në Fakultetin e Sheriatit në

Rrijad, pastaj si mësues në Universitetin Islamik të Medines dhe pastaj në Fakultetin e Sheriatit. E kam njohur me Akijde të saktë dhe largpamësi e mprehtësi. Ai është përpjekur duke ftuar tek Akijdeja e Selefëve tanë të Mirë dhe duke paralajmëruar kundër bidatit, kjo nëpërmjet mësimeve, mexhliseve dhe librave të tij kundër bidatit. Allahu e faltë dhe pastë mëshirë për të dhe e shpërbleftë me të mira.”

Shejkh Salih el-Feuzan shkruan:

“Shejkh Muhamed Aman, ashtu si e kam njohur: Vërtet profesorët dhe ata që mbajnë diploma të studimeve të larta e të fushave të ndryshme janë të shumtë. Mirëpo, të paktë janë ata prej të cilëve përfitohet dija apo që mund të përfitohet prej tyre. Dhe Shejkh Muhamed Aman el-Xhamij është prej atyre Ulemave të paktë e të rrallë, të cilët vunë në punë dijen dhe mundin e tyre në dobi të Muslimanëve, në udhëzimin e tyre, duke i thirrur tek Allahu me dije të saktë, nëpërmjet mësimdhënies në Universitetin Islamik dhe në Xhaminë e Nderuar të Pejgamberit, në udhëtimet e tij në vende të ndryshme Islame, qoftë jashtë apo brenda Mbretërisë (së Arabisë Saudite), për të dhënë mësim apo ligjërata në krahina të ndryshme, duke thirrur në Teuhid, duke përhapur Akijden e saktë, duke udhëzuar të rinjtë e Umetit në Menhexhin e Selefëve të Devotshëm, si dhe duke i paralajmëruar nga ideologjitë shkatërrimtare dhe thirrjet devijante. Dhe kush nuk e njeh atë pesonalisht, atëherë do ta njohë atë nëpërmjet librave të tij të dobishëm apo nëpërmjet kasetave të tij të shumta që përmbajnë bollëk me dije dhe dobi të shumta.”

Shejkh Felah Ibn Isma'il Mindikar thotë për të: “Kam përfituar nga ai një moral fisnik.”

Thotë gjithashtu: “Ai gëzonte një pozitë të lartë tek dijetarët, sidomos tek Shejkh Ibn Bazi. Ai e dërgonte Shejkh Muhamed Amanin në vende të ndryshme, veçanërisht në Afrikë. Shejkh Ibn Bazi e ngarkonte atë me detyrën e zgjidhjes së problemeve të ndryshme që dilnin.”

Thotë gjithashtu: “Shejkh Hammad el-Ensarij thoshte se Shejkh Muhamed Aman el-Xhamij e di akijden e Esharive më mirë sesa vetë Esharitë.”

Prej studentëve të tij më të njohur përmendim:

Shejkhu i nderuar Rabij' Ibn Hadij el-Medkhalij;
Shejkhu i nderuar Zejd Ibn Hadij el-Medkhalij;
Shejkhu i nderuar 'Ai Ibn Nasir el-Fekijhi;
Shejkhu i nderuar Salih Ibn Sa'd es-Suhejmi;
Shejkhu i nderuar Felah Isma'il el-Mindikar;
Shejkhu i nderuar 'Abdullah Ibn 'Abdur-Rrahim el-Bukharij;

...e shumë të tjerë.

Shejkhu njihej që shumë pak përzihej me njerëzit, përveç atëherë kur kishte mirësi e dobi. Ai e programonte më së miri kohën e tij. Dilte nga shtëpia për të shkuar në punë në Universitet, e pasi mbaronte aty kthehej në shtëpi dhe më vonë shkonte në Xhaminë e Pejgamberit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) që të jepte mësim mbas namazit të Ikindisë, pastaj jepte mësim mbas namazit të Akshamit, mbas namazit të Jacisë dhe më vonë mbas namazit të Sabahut. Ai vazhdoi kështu derisa në fund zuri në shtratin e tij për shkak të sëmundjes së tij të rëndë.

Shejkhu ishte gjithashtu shumë i kujdesshëm me gjuhën e tij dhe nuk përgojonte e nuk fliste keq për asnjëri, saqë ai nuk lejonte

askënd në shoqërinë e tij që të fliste keq për ndonjë tjetër dhe për më tepër, ai nuk lejonte që të diskutoheshin në prani të tij fjalët e kota apo gabimet e njerëzve.

Nëse ndonjë prej studentëve të tij gabonte, Shejkhu kërkonte kasetën apo librin (ku ndodhej gabimi) dhe do ta dëgjonte ose do ta lexonte, nëse do t'i bëhej e qartë që është gabim, do ta takonte personin që kish gabuar në mënyrën më të mirë e do ta këshillonte.

Kishte prej atyre që e mallkonin dhe e shanin atë,¹ porse ai thjesht ua bënte hallall atyre dhe thoshte: “Shpresoj që Allahu të mos fusë askënd në Zjarr për shkakun tim.”

Ai thoshte në mexhliset dhe tubimet e tija të dijes: “Ia kam bërë hallall çdokujt që më ka përgojuar” - dhe u kërkonte të pranishmëve që ta përhapnin këtë fjalë.

Shejkhu ishte gjithashtu i interesuar për studentët e tij, jo vetëm gjatë mësimit në universitet, por edhe jashtë tij. Ai merrte pjesë në mbledhjet e tyre dhe i pyeste për gjendjen dhe problemet e tyre dhe i ndihmonte me këshilla apo edhe nga ana financiare.

Gjatë fundit të jetës së tij, Shejkhu u sëmur rëndë dhe qëndroi në këtë gjendje, i shtrirë në krevatin e tij, për afro një vit, duke bërë durim me atë që i kishte rënë.

Në mëngjesin e ditës së enjte, 26 Shaban, 1416 Hixhrij, Shejkhu u nda nga kjo jetë. Namazi i xhenazes iu fal pas namazit të Drekes të së njëjtës ditë dhe u varros në varrezat *el-Bekij el-Garkad* në Medine.

¹ **Shënim:** Lexo për më tepër shkrimin e Shejkh ‘Ali Jahja el-Haddadij: http://selefi.org/index.php?option=com_content&view=article&id=661:ky-eshte-xhamiizmi-te-ashtuquajturit-xhamije&catid=44:refuzim-i-dyshimeve-dhe-vesveseve-rreth-menhexhit&Itemid=74

Shumë njerëz morën pjesë në xhenazen e tij, midis tyre dijetarë, gjykatës, studentë e të tjerë.

Me vdekjen e tij, Umeti humbi një prej atyre dijetarëve që punuan me dijen e tyre të pastër. Shejkh 'Abdullah Bukhari thotë se fjalët e fundit që ai thoshte kur ishte i shtrirë në shtrat ishte porosia e tij që t'i kushtohej rëndësi Akijdes së pastër të kësaj feje. Vazhdoi ta përsëriste këtë porosi derisa ra në gjendje kome. Pastaj doli nga ajo gjendje por nuk mund të shqiptonte dot asnjë fjalë, veç bënte me shenjë me dorën e tij duke përsëritur porosinë që t'i kushtohet rëndësi Akijdes Selefije. Pastaj vdiq.

Lusim Allahun *Subhanehu ue Te'ala* që ta falë dhe të ketë mëshirë për të, si dhe i lutemi Atij që të sjellë për këtë Umet të tjerë dijetarë që punojnë me dijen e tyre të pastër.²



² Përgatiti biografinë: Alban Malaj.

Hyrje

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirëshmit, Mëshirëplotit.³

Falenderimi i takon Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut dhe begatia e Tij qofshin mbi të Dërguarin e Allahut, mbi Familjen e tij, Shokët e tij dhe mbi ata që i pasuan.

E më tej:

Universitetit Islamik të Medines së Ndritur iu bë një ftesë e përzemërt nga Këshilli i Lartë i Muslimanëve të Kenias në Nairobi, që të merrte pjesë në këtë seminar fetar të bekuar, inshaAllah.

Kështu, Universiteti e mori iniciativën dhe e pranoi ftesën, pastaj kërkoi prej meje që të merrja pjesë në seminar si përfaqësues i tij me një studim që do të paraqisja në të.

Natyrisht që e pranova kërkesën sepse kjo lloj kërkesë nuk refuzohet. Dhe sepse pranimi i kësaj kërkesë është kontribut në fushën e thirrjes për tek Allahu dhe thirrja për tek Allahu është nga qëllimet më të rëndësishme të Universitetit Islamik dhe për këtë arsye është themeluar.

Kështu pra, unë paraqitem me këtë studim modest me titull: **“Rendi familjar në Islam”**.

E lus Allahun që t’i bëjë punët tona të singerta për Fytyrën e Tij Fisnike, vërtet Ai është më Miri nga i Cili kërkohet dhe Dhuruesi më Bujar.

³ **Shënim:** Nxjerrja e haditheve të cilat gjenden në libër nuk është bërë prej Shejkh Muhamed Aman El-Xhami, Allahu e mëshiroftë.

Duke kërkuar ndihmën e Allahut të Vetëm, them:

Vërtet, thirrja Islame ka sfera të larmishme dhe metoda të ndryshme. Prej metodave të saj është edhe mbajtja e seminareve dhe konferencave të cilat mbahen prej mendimtarëve dhe fukahave Muslimanë, që të kurojnë problemet e kohës dhe të refuzojnë dyshimet që hidhen rreth Islamit dhe akijdes së muslimanëve dhe t'u sqarojnë njerëzve që kanë nevojë për sqarim, shtyllat e fesë Islame në të gjitha fushat e jetës – e sa të shumtë janë ata që kanë nevojë për sqarim – në mënyrë që njerëzit të jenë të qartë rreth çështjeve të fesë dhe dynjasë së tyre dhe kjo bëhet nën dritën e Kur'anit dhe Sunetit, që njerëzit të dalin prej errësirës në dritë. Nuk mund të dilet prej errësirës së injorancës dhe xhahilijetit, vetëm se duke kuptuar Kur'anin dhe Sunetin dhe pikërisht kjo është detyra e të Dërguarve, *'alejhimus-salatu ues-selam*, që nga i pari i tyre që ishte Nuhu, *'alejhis-salatu ues-selam*, e deri tek Vula e tyre dhe Imami i tyre, Muhamedi, mbi të qofshin lavdërimet dhe bekimet më të mira prej Zotit të tij.

Dhe thotë Allahu i Lartësuar duke iu drejtuar Pejgamberit të Tij fisnik, Muhamedit, *'alejhis-salatu ues-selam*, duke sqaruar detyrën e tij dhe detyrën e atyre që e ndjekin atë:

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِنَّا أَرْسَلْنَاكَ شَهِيدًا وَمُبَشِّرًا وَنَذِيرًا ﴿٤٥﴾ وَدَاعِيًا إِلَى اللَّهِ بِإِذْنِهِ ۖ وَسِرَاجًا مُنِيرًا

﴿٤٦﴾ وَبَشِّرِ الْمُؤْمِنِينَ بِأَنَّهُمْ مِّنَ اللَّهِ فَضْلًا كَبِيرًا

“O Pejgamber! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues; njëkohësisht (të kemi çuar) si thirrës, që i fton njerëzit në rrugën e Allahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues. Jepu lajmin e mirë besimtarëve se Allahu ka (përgatitur) për ata mirësi të madhe”⁴

⁴ El-Ahzab, 45-47.

Në këto tre ajete të sures Ahzab sqarohet detyra e të Dërguarit fisnik Muhamedit, ‘*alejhis-salatu ues-salam*, dhe detyra e ndjekësve të tij.

Dhe ajo është thirrja për tek Allahu me lejen e Tij dhe urdhërin e Tij me dituri të plotë:

قُلْ هَذِهِ سَبِيلِي أَدْعُوا إِلَى اللَّهِ عَلَىٰ بَصِيرَةٍ أَنَا وَمَنِ اتَّبَعَنِي ۖ وَسُبْحَنَ اللَّهُ وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ

“Thuaj: Kjo është rruga ime: të ftoj drejt Allahut me dituri të plotë, unë dhe çdokush që më pason mua.”⁵

Allahu e ngarkoi Pejgamberin e Tij me këtë thirrje gjithëpërfshirëse, e cila nuk është specifike vetëm për popullin e tij, siç ka qënë thirrja e të Dërguarve përpara tij, por ajo është për të gjithë njerëzimin:

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا كَافَّةً لِّلنَّاسِ

“Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) të mjaftueshëm për të gjithë njerëzimin”⁶

Dhe kjo detyrë është për të dhe për ata që e ndjekin atë, më pas pasuesit e tij duhet ta dëshmojnë këtë para gjithë njerëzimit. Kjo do të thotë se Mesazhi i Muhamedit ka përparësi përpara të gjitha feve, pra feja e tij është ligji i fundit, aq sa njeriu nuk ka zgjidhje tjetër veçse ta ndjekë atë dhe nuk lejohet kundërshtimi i tij.

Ai është ligj i përsosur prej Zotit sepse Allahu që krijoi këtë qenie të përkryer që është njeriu, prej Urtësisë së Tij është se nuk ka sesi ta

⁵ Jusuf, 108

⁶ Sebe’, 28

lërë njeriun të braktisur pa urdhëresa, ndalesa apo udhëzime dhe ta lërë atë në kaos, të endet i verbër, të lejojë dhe të ndalojë ashtu siç ia ka qejfi apo të adhurojë çfarë të dojë. Jo! Përkundrazi, Ai e sistemoi jetën e tij dhe marrëdhëniet e tij të ndryshme, dërgoi të Dërguarit e Tij pikërisht për këtë qëllim, u zbriti atyre Librat e Tij, dërgoi Vulën e të Dërguarve të Tij, Muhamedin, ‘*alejhis-salatu ues-salam*, pas të cilit nuk ka Pejgamber tjetër dhe Librin e Tij të fundit, Kur’anin Fisnik, pas të cilit nuk ka libër tjetër dhe sqarimin e shpjegimin i këtij Libri e bën Suneti i kulluar:

بِالْيَمِينِ وَالزُّبُرِ وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ

“Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm Përkujtesën (Kuranin), me qëllim që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë.”⁷

Dhe me të gjitha këto, Islami e sistemoi lidhjen e robit me Zotin dhe Krijuesin e tij, që ai të jetë vetëm rob i Atij, duke e adhuruar Atë të Vetëm, pa i shoqëruar askënd në adhurim. E adhuron Atë me një adhurim sistematik, të saktë, të bazuar në kritere sheriatike, më pas Kur’ani është ai që e sistemoi atë (lidhjen e robit me Zotin e tij) në mënyrë të tërësishme e të hollësishme. Po ashtu, e shpjegoi atë Suneti i kulluar duke e qartësuar dhe sqaruar atë, pavarësisht niveleve dhe degëve të saj të shumta. Dhe për këtë i Dërguari thotë:

الإيمان بضع وستون شعبة، أعلتها قول لا إله إلا الله، و أدناها إمطة اللأدى عن الطريق. و الحياء من الإيمان.

“Imani është gjashtëdhjetë e ca degë, më e larta e tij është fjala **La ilahe il-la Allah** dhe më e ulta është heqja e një pengese nga rruga; edhe turpi është degë e imanit.”⁸

⁷ En-Nahl, 44

⁸ Transmeton Muslimi (35) nga hadithi i Ebi Hurejrës, *radijAllahu ‘anhu*.

Dhe të gjitha këto degë janë adhurim dhe bindje, pavarësisht dallimeve që kanë.

Dhe të gjitha adhurimet duhet që të jenë të lidhura me Sheriatin e Allahut, i cili e ka zanafillën tek Libri i Allahut dhe Suneti i të Dërguarit të Tij, ‘*alejhis-salatu ues-salam*, varen (adhurimet) nga gjykimet e Tij dhe robi duhet të ndjekë këtë rrugë në të gjitha adhurimet e tij, marrëdhëniet e tij, sjelljen e tij, kjo është domethënia e lidhjes mes robit dhe Zotit të tij dhe ky është nënshtrimi i singertë dhe realiteti i tij është që robi të mos e lërë atë që Zoti ia ka urdhëruar dhe as të veprojë atë që Zoti ia ka ndaluar. Dhe nëse gabon ndonjëherë dhe e kundërshton urdhërin e Zotit të tij, ai nxiton në pendim dhe kthim në atë që është e drejtë, në mënyrë që t’i fshijë gjurmët e kundërshtimit dhe mosbindjes së tij me teube dhe keqardhje sepse teubeja e fshin atë që ka ndodhur më përpara:

﴿وَتُوبُوا إِلَى اللَّهِ جَمِيعًا أَيُّهَ الْمُؤْمِنُونَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ﴾ 

“Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin.”⁹

Pra shkurtimisht, kështu e sistemon Islami lidhjen e robit me Zotin dhe Krijuesin e tij. Ashtu siç e sistemoi këtë lidhje në drejtimin që përmendëm, ashtu Islami i kushton rëndësi edhe sistemimit familjar.

Islami nxit në themelimin e institucionit të familjes duke e ligjëruar martesën, duke nxitur për të e duke sqaruar se martesa është prehje dhe qetësi për të dyja palët, është pushim për trupin, paqe për shpirtin dhe të zgjat jetën deri në fund të ciklit të saj.

⁹ En-Nur, 31.

Le të shijojmë tani disa prej ajeteve të Kur'anit që flasin për këtë kuptim, në thënien e Allahut të Lartësuar që e nxit robin e Tij drejt martesës:

فَانكِحُوا مَا طَابَ لَكُمْ مِنَ النِّسَاءِ مَثْنَىٰ وَثُلَاثَ وَرُبْعَ ۚ

“Martohuni me ato gra që ju pëlqejnë: me dy, me tri apo me katër.”¹⁰

Dhe thotë:

وَمِنْ ءَايَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا
وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً وَرَحْمَةً ۚ

“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë.”¹¹

Dhe ku thotë:

هُنَّ لِبَاسٌ لَكُمْ وَأَنْتُمْ لِبَاسٌ لَهُنَّ

“Ato janë petk për ju e ju jeni petk për ato.”¹²

Dhe thotë:

نَسَاؤُكُمْ حَرْتُ لَكُمْ فَأَتُوا حَرَّتَكُمْ أَنِّي شِعْتُمْ وَقَدِّمُوا لِأَنْفُسِكُمْ وَاتَّقُوا اللَّهَ

¹⁰ En-Nisa, 3

¹¹ Er-Rum, 21

¹² El-Bekare, 187

“Gratë tuaja janë “ara” për ju, prandaj iu afroni “arave” tuaja si të doni. Por bëni diçka (të mirë) për veten tuaj (duke përmendur emrin e Allahut para kontaktit) dhe kijeni frikë Allahun.”¹³

Pra, kështu flet Kur’ani në shumë ajete për institucionin e familjes dhe me mënyra të ndryshme, ashtu siç e pamë dhe ashtu siç do të dëgjojmë sërish në ajetin e sures En-Nisa, e cila sqaron se të dy palët e këtij institucioni janë krijuar prej një veteje të vetme, sikur të ishin dy kushte për një vete të vetme dhe asnjë prej të dyve nuk ka epërsi mbi tjetrin nga origjina e krijimit dhe i përbërjes, por epërsia mes tyre ndodh për çështje të jashtme e faktorë të tjerë, për karakteristika të përftuara dhe jo në vetvete, ngaqë Allahu thotë për këtë kuptim:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً ۚ

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra.”¹⁴

Kështu nxit Islami në krijimin e familjes, që të jetë zgjatëse e jetës dhe qetësi për të dy palët.



¹³ El-Bekare, 223.

¹⁴ En-Nisa, 1.

Qëllimi i martesës në Islam

Sheriati Islam është legjislacion me urtësi e ai ka qëllime dhe domethënie... dhe prej emrave të Allahut të Lartësuar është “*el-Hakim*”, i Urti, prandaj është obligim që në mënyrë kategorike të besojmë se Allahu i Lartësuar është i Urtë në legjislacionin e Tij, ashtu siç është i Urtë në krijimin dhe veprat e Tij.

Kështu pra, ligjërimi i martesës konsolidohet në çështjet e mëposhteme:

1- Ulla e shikimit nga të dyja palët:

Islami i ka kushtuar rëndësi kësaj çështjeje në Kur'an dhe në Sunetin e Pejgamberit, *sal-lAllahu 'alejhi ue sellem*. Thotë Allahu i Lartësuar kur Ai i urdhëron që të dy, burrin dhe gruan që ta ulin shikimin:

قُلْ لِلْمُؤْمِنِينَ يَغُضُّوا مِنْ أَبْصَارِهِمْ وَيَحْفَظُوا فُرُوجَهُمْ ۚ ذَٰلِكَ أَزْكَىٰ لَهُمْ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ
بِمَا يَصْنَعُونَ ﴿٢٤﴾ وَقُلْ لِلْمُؤْمِنَاتِ يَغْضُضْنَ مِنْ أَبْصَارِهِنَّ وَيَحْفَظْنَ فُرُوجَهُنَّ

“Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara) dhe ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)! Kjo është më mirë për ta! Me të vërtetë, Allahu është i Dijshëm për atë që bëjnë ata. Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme).”¹⁵

¹⁵ En-Nur, 30, 31.

Dhe neglizhenca në uljen e shikimit shpie në shthurje të moralit, siç e shohim edhe sot në shumë prej qyteteve dhe kryeqyteteve Islame, për fat të keq.

2- Ruajtja e nderit:

Pra, ajetet të cilat u përmendën më lart përmbajnë urdhërin për ruajtjen e nderit (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) së bashku me urdhërin e uljes së shikimit, sepse ndoshta si rezultat i të parës vjen e dyta, dmth se ulja e shikimit sjell ruajtjen e nderit në më të shumtën e rasteve, ngase kush i frikësohet Allahut të Lartësuar, rrjedhimisht ai do ta ulë shikimin prej frikës që ka nga Allahu dhe duke i ardhur turp nga Ai do ta ruajë nderin e tij nga ajo që Allahu ia ka bërë haram dhe kështu nuk bie në imoralitet. Dhe ka ardhur transmetim i saktë nga ai, *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*, fjala e tij:

العَيْنَانِ تَزْنِيَانِ وَ زَنَاهُمَا النَّظَرُ وَ الْأَذْنَانِ تَزْنِيَانِ وَ زَنَاهُمَا السَّمْعُ.

“Të dy sytë bëjnë zina dhe zinaja e tyre është shikimi dhe të dy veshët bëjnë zina dhe zinaja e tyre është dëgjimi.”¹⁶

3- Arritja e pasardhësve:

Dhe ky është thelbi i ndërtimit të shoqërisë dhe arsyeja e shtimit të pasuesve të Vulës së të Dërguarve dhe Pejgamberëve.

Dhe çështja bëhet akoma më e qartë nga hadithi të cilin e transmeton Bukhari në Sahihun e tij nga Abdullah Ibn Mes'udi, me të cilin i Dërguari fisnik, *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*, i drejtohet me butësi të rinjve muslimanë që t'i udhëzojë dhe drejtojë ata në atë që është në të mirën e tyre, kur thotë:

¹⁶ Transmeton Bukhari (6612) dhe Mslimi (2657) nga hadithi i Ebi Hurejrës, *radijAllahu anhu*.

يا معشر الشباب من استطاع منكم الباءة فليتزوج فإنه أغض للبصر وأحصن للفرج ،
ومن لم يستطع فعليه بالصوم فإنه له وجاء.

“O ju të rinj, kush e ka mundësinë (e shpenzimeve të martesës dhe aftësisë për marrëdhënie), le të martohet sepse ajo është më e mirë për të ulur shkimin dhe për të mbrojtur nderin, e kush nuk ka mundësi, le të agjërojë sepse ai e dobëson e epshin.”¹⁷

Dhe gjendet tek Bejhakui nga hadithi i Ebi Umames:

تَزَوَّجُوا فَإِنِّي مُكَاثِّرٌ بِكُمْ النَّامَ.

“Martohuni, ngase unë do të krenohem me numrin tuaj para popujve të tjerë.”¹⁸

Dhe u përmendën më herët disa prej kuptimeve që mund të konsiderohen prej qëllimeve të martesës, siç është qetësia dhe prehja për shembull.

Dhe gabojnë ata të cilët mendojnë se qëllimi i martesës është arritja e kënaqësisë dhe qejfit si të të vijë për mbarë, dhe përveç këtij nuk kanë qëllim tjetër; ky është përshkrim i gabuar dhe shumë prej të rinjve kanë rënë në rreziqe shkatërrimtare, në prishje të moralit dhe degjenerim, saqë jeta e shumë prej tyre në vende të ndryshme është bërë e ngjashme me jetën e kafshëve, të cilat nuk kanë përgjegjësi, përkundrazi ata njerëz janë akoma më të humbur se kafshët dhe në gjendje akoma më të mjerueshme.



¹⁷ Transmeton Bukhari (5065) dhe Muslimi (1400) nga hadithi i ibn Musudit, *radijAllahu anhu*.

¹⁸ Transemotn Bejhakui në “Es-Sunen el-Kubra” (78/7) nga hadithi i Ebi Umames, *radijAllahu anhu*, dhe el-Albani e ka bërë sahih në *Sahihul Xhami’* (2941).

Kush e merr përsipër drejtimin e institucionit të familjes

Vërtet Islami nuk e ka lënë pas dore drejtimin e e këtij institucioni dhe sqarimin se kush e kryeson dhe kush janë atë që e marrin përsipër përgjegjësinë e saj.

Ajo që është bërë e qartë nga mësimet Islame, është se detyrat dhe autoriteti ndahen mes të dy palëve dhe se detyrat janë të përcaktuara dhe secili prej palëve është përgjegjës për to:

Kështu, burri ka detyra të cilat nuk i ka gruaja dhe as ai nuk e mban dot barrën e punëve dhe aktivitetin e saj, e po ashtu gruaja ka detyra që nuk janë të përshtatshme për burrin dhe ai nuk mund t'i kryejë ato.

Dhe përpjekja e ndonjërës prej palëve që të hyjë në detyrat e palës tjetër, e çon këtë institucion në çoroditje, çrregullim dhe trazira.

Le të kënaqemi me disa ajete Kuranore, të cilat sistemojnë jetën familjare dhe përcaktojnë përgjegjësitë dhe i jep burrit kujdestarinë dhe drejtimin, ku thotë Allahu Azze ue Xhel:

الرِّجَالُ قَوَّامُونَ عَلَى النِّسَاءِ بِمَا فَضَّلَ اللَّهُ بَعْضَهُمْ عَلَى بَعْضٍ وَبِمَا أَنْفَقُوا مِنْ أَمْوَالِهِمْ ۚ فَالصَّالِحَاتُ قَنِتَاتٌ حَافِظَاتٌ لِّلْغَيْبِ بِمَا حَفِظَ اللَّهُ ۚ

“Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi ato dhe, meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre. Gra të mira janë ato të dëgjueshmet, që ruajnë fshehtësitë që ka urdhëruar Allahu.”¹⁹

¹⁹ En-Nisa, 34.

Pra, ajeti është i qartë se i jep burrit të drejtën e drejtimit të familjes dhe kujdestarisë e saj ashtu siç shihet. Dhe ajeti nuk e lë pas dore sqarimin e arsyes, përkundrazi e sqaron atë, ngase Allahu Azze ue Xhel thotë:

بِمَا فَضَّلَ اللَّهُ بَعْضَهُمْ عَلَى بَعْضٍ وَبِمَا أَنْفَقُوا مِنْ أَمْوَالِهِمْ

“Meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi ato dhe meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre.”

Pastaj, nuk diskutohet se çdo institucion apo kompani, zgjedh për drejtimin e saj dikë që ka njohuri, eksperiencë dhe takat për drejtimin e saj, durim në punë, ekperiencë në politikën që i shkon i për shtat punës; dhe institucioni i familjes është nga më të rëndësishmet në mënyrë absolute sepse me përmirësimin e saj, përmirësohet shoqëria dhe me prishjen e saj, prishet shoqëria; ngase është ajo që i jep shoqërisë individë të cilët janë materia e ndërtimit të shoqërisë dhe ndërtesa i përfiton vetitë e saj nga lënda e përdorur për ndërtim, e dobët apo e fortë qoftë.

Dhe për shkak të të gjitha këtyre, Islami ia ngarkoi burrit këtë detyrë; ai është amanet i rëndë (për tu mbajtur), pasi burri është më i përshtatshëm për këtë punë dhe më i fortë në kryerjen e saj dhe gruaja që është e drejtë e pranon këtë gjë.

Thotë Profesor Muhamed El-Gazali²⁰ në librin “Të drejtat e njeriut në Islam”:

²⁰ **Shënim:** Kjo ligjëratë e Shejkhut është goxha e vjetër, atëherë kur dijetarëve në Arabinë Saudite akoma nuk iu ishte bërë e qartë gjendja e shumë personaliteteve të Egjiptit apo të mbarë Botës Islame. Prandaj mos u habit përse Shejkhun i referohet Gazalit në këtë rast. Gjithësesi, më vonë Shejkh Muhamed Aman el-Xhamij

“Për shakak se burri është larg preokupimit të hajdit, nifasit, shtatëzanisë dhe gjidhënies, ai është më i aftë në përballjen me vështirësitë dhe vuajtjet e punëve të ndryshme; dhe udhëtimi nëpër botë për të kërkuar rizkun ishte më i përshtatshëm për të, atëherë

(*rahimehullah*) e ka refuzuar fuqishëm Muhamed Gazzalin dhe ka nxjerrë në dritë devijime të mëdha tek ai.

Ka thënë Shejkh Muhamed Aman (*rahimehullah*): “Pyetësi pyet për disa dijetarë të Esharive, ata të cilëve iu është bërë i qartë udhëzimi gjatë debateve dhe refuzimeve që janë shkruajtur kundër tyre, dhe ata jetojnë mes Selefijinëve. Gjatë debateve, refuzimeve, përgjigjeve dhe kundërpërgjigjeve atyre iu bë i qartë udhëzimi dhe ata mbetën mëse të sigurtë se Menhexhi i Selefëve është haku. Por megjithëkëtë, ata u bënë fanatikë për menhexhin e tyre të vjetër Eshari. Dhe ata u hedhin disa dyshime disa studentëve se *te`uili* (interpretimi i Emrave dhe Cilësive të Allahut) është *uaxhib* (obligim) ose këtu s’ka vend fare për interpretim. Kështu i ngatërrojnë disa studentë, ndërkohë që ata (fanatikët e Esharizmit) kanë dije (për hakun). Pyetësi pyet: A justifikohen ata apo jo? Përgjigja është: Jo, nuk justifikohen. Dhe kujt i bëhet i qartë Udhëzimi dhe ndjek rrugë tjetër në vend të Rrugës së Besimtarëve, ai nuk justifikohet. Ai që justifikohet është ai të cilit nuk i është bërë i qartë haku dhe nuk i është bërë i qartë udhëzimi. Dhe pyetësi ka sjellë si shembull Shejkh (Muhamed ‘Ali) es-Sabunij dhe Muhamed el-Gazzalij. Sa i përket Shejkh Sabunit, ai u tregua fanatik për Esharizmin e tij dhe për Sufizmin e tij, pasi që jetoi për një kohë të gjatë në Universitetin Ummul-Kura. Studentët e dijes debatuan me të dhe ia bënë të ditur hakun, por ai u tregua fanatik. S’ka justifikim për të. Kurse Gazzali nuk u ndal tek fanatizmi, porse filloi të poshtërojë Selefët e Mirë, Hadithin, Dijetarët e Hadithit, dhe të armiqësojë Ehli-Sunetin. Ai jo vetëm që nuk justifikohet me injorancë, porse ka arritur gjer në kufirin e *ilhadi* (mosbesimit).”

Dhe ka thënë gjithashtu: “Ai thërret për afrim midis Rrafidave dhe Ehli-Sunetit dhe ai e qorton Ehli-Sunetin: “Përse ju i kritikoni Rrafidat? Përse nuk i merrni librat e tyre për studimet e larta e për studimet elementare?” Propozon Gazzali që të futen librat e Rrafidave në Universitetet tona, për studimet e larta dhe për studimet elementare. Mes librave që propozon Gazzali është el-Kafij. El-Kafij tek Rrafidat është si pozita që ka Bukhari tek Ehli-Suneti. Mirëpo, pa e egzagjëruar, tetëdhjetë përqind e çështjeve që pëmban libri el-Kafij është kufër i qartë (*kufun beuah*). Në të ka sharje ndaj es-Siddijkah Bintu es-Siddijk (‘Aishah Bin Ebij Bekr) se ajo nuk është e ndershme nga akuzat që i bënë; prej tyre është tekfiri mbi të gjithë Sahabët, me përjashtim të Ehli-Bejrit, domethënë përveç ‘Aliut dhe bijtë e tij, kurse të gjithë të tjerët janë qafira. Ebu Bekri qafir, ‘Umeri qafir, ‘Uthmani qafir, e gjer në fund... Dhjetë të Përgëzuar me Xhenet janë qafira sipas tyre. Këto gjenden tek el-Kafij që na propozon Gazzali ta fusim në universitetet tona...” <http://www.youtube.com/watch?v=d1iEdwr6C8k>

[Përktheu: Alban Malaj]

Islami ia ngarkoi atij shpenzimet për gruan e tij dhe femrave të varfëra prej të afërmve të tij.”

Kjo që përmend Profesor Gazali është një aspekt i rëndësishëm dhe i logjikshëm pse burri është më meritore për detyrën e kujdestarisë.

Ka edhe aspekte të tjera që dalin në pah nga reflektimi në disa drejtime, të cilat janë shumta. Por, po mjaftohemi me atë që sa përmendëm për të kursyer kohën.



Përgjegjësia e gruas në Islam

Përderisa burri është i ngarkuar për të vënë në lëvizje politikën e jashtme dhe ekonomike të familjes, siç edhe e përshkruam, atëherë gruaja është përgjegjëse për drejtimin e brendshëm të familjes e të ruajtë shtëpinë e burrit të saj në prani dhe mungesë të tij. Po ashtu, të ruajtë pasurinë e tij dhe fëmijët e tij. Dhe ajo ka për detyrë sistemimin e shtëpisë edhe çështjet e tjera që lidhen me të.

Dhe për këtë arsye, ajo gëzon nder e respekt nga anëtarët e familjes për atë kohë sa e ruan përgjegjësinë e saj në familje dhe nuk merr përsipër diçka që nuk mund ta kryejë pasi është kompetencë e burrit.



Islami nuk i bën padrejtësi gruas

Të shumtë janë zërat dashakeq të cilët propagandojnë se Islami ka shkelur të drejtat e gruas dhe i ka bërë asaj padrejtësi dhe se nuk i jep lirinë e saj dhe se nuk barazon mes saj dhe burrit dhe të tjera shprehje si këto, të cilat i shkruajnë armiqtë e Islamit kundër Islamit.

Dhe në fakt, thënësit e këtyre propagandave janë njëri nga këta të dy:

1 - Ose ndonjë injorant i pafajshëm i cili i ka dëgjuar nga njerëzit këto shprehje dhe i pason ata dhe për më tepër bëhet tellalli i tyre duke përhapur atë që thonë ata dhe s'ka asnjë argument në të cilin të mbështetet për atë që thotë dhe përhap, madje nuk ka punë tjetër përveç njoftimit të njerëzve. Dhe ky flet përçart për gjëra të cilat nuk i di.

Dhe me të vërtetë, nga ai janë mashtruar shumë njerëz të cilët nuk kuptojnë asgjë nga feja dhe veçanërisht gra të edukuara me një kulturë jo-Islame ose injorante të cilat nuk e pasojnë udhëzimin.

Dhe ky njeri është prej asaj kategorije njerëzish që janë të devijuar dhe devijues të të tjerëve sepse ai është injorant dhe në të njëjtën kohë ai nuk e di që nuk di, e i shkon për shtat thënia: “E nëse nuk e di që nuk di, atëherë kjo është injorancë e dyfishtë”.

2 - Ndërsa i dyti, është njeri dinak i cili thur plane e kurthe kundër Islamit dhe Muslimanëve dhe do që t'ua prishë fenë dhe moralin e tyre nëpërmjet prishjes së familjes. Ai është i ndikuar nga armiqtë e Islamit dhe është zbatues i planeve të tyre në luftimin e Islamit.

Pra, janë këta dy lloje njerëzish që po i lëshojnë këto zëra dashakeqë në çdo vend duke u munduar që të devijojnë të tjerët dhe me të vërtetë janë ndikuar prej tyre shumë prej muslimaneve injorante duke menduar se këto thirrje bëhen për të mirën e tyre dhe kështu që zërat e këtyre grave i janë bashkangjitur atyre zërave të tjerë.

Pra, në këtë mënyrë ndikohet gruaja muslimane prej këtyre thirrjeve dhe bëhet e padrejtë me fenë e saj dhe Islamin e saj, duke e akuzuar atë (Islamin) se i ka bërë padrejtësi, ai Islam i cili e ka ngritur lartë pozitën e saj. Ah sikur ta dinte dhe të kuptonte! Por, ku kuptojnë gratë tona, me përjashtim të asaj që do Allahu. Dhe Allahu na qoftë në ndihmë!

Kështu që, është detyrë për gruan muslimane të kulturuar që ta mësojë fenë e saj, në mënyrë që ta njohë qëndrimin e Islamit ndaj gruas dhe nderin që gëzon ajo në Islam dhe të mos ndjekë çdo kënd që bërtet.

Dhe në të njëjtën kohë, ajo duhet të shohë ligjet e huaja, siç janë për shembull ligjet franceze e të tjera si ato, në mënyrë që ta dijë qëndrimin e këtyre ligjeve ndaj gruas, e më pas të marrë vesh se si ka qënë gruaja para Islamit, atëherë kur ka qënë si diçka e hedhur, e ultë në vlerë dhe në nder dhe nuk ia ktheu nderin asaj përveç se Islami.



Gruaja në Islam gëzon të njëjtat të drejta civile sikurse burri

Gruja muslimane ka liri të plotë në të drejtat civile dhe ka po të njëjtat të drejta ashtu sikurse edhe burri.

Kështu, gruaja muslimane ka të drejtë të shesë e të blejë, të dhurojë e të pranojë dhurata, të japë e të marrë hua, ajo ka liri të plotë në pasurinë e saj, ajo ka të gjitha të drejtat në pasuri ashtu si burri.



Të drejtat fetare të gruas muslimane

Gruas muslimane i janë bërë detyrë të gjitha adhurimet njësoj si burri. Kështu, ajo falet, agjëron, jep zekat për pasurinë së saj, kryen haxhin dhe shpërblehet për adhurimet e saj dhe për bindjen e saj njësoj siç shpërblehet edhe burri, e nuk është shpërblimi i saj më i vogël se shpërblimi i burrit.

Vetëm se Islami e ka lehtësuar gruan në disa ibadete duke marrë në konsideratë arsyet e saj të pazakonta, për shembull: i është lejuar gruas me menstruacione që ta lërë namazin dhe nuk është urdhëruar që ta kompesojë atë pasi të pastrohet për shkak se është ngushtim dhe vështirësi për të:

وَمَا جَعَلَ عَلَيْكُم فِي الدِّينِ مِنْ حَرَجٍ

“Dhe nuk ju ka vënë asnjë barrë në fe.”²¹

Dhe ajo ka të drejtë që ta lërë agjërimin gjatë ditëve të zakoneve të saj, por i kompeson ato sipas mundësisë pa u vënë në vështirësi në kompesimin e ditëve, ndryshe nga namazi. Edhe gratë me nifas (lehoni) veprojnë në të njëjtën mënyrë po ashtu.



²¹ El-Haxh, 78.

Liria e gruas muslimane për t'u martuar

Islami i jep gruas liri të plotë në martesë. Pra, është ajo e cila e zgjedh burrin e duhur për të, përpara se kujdestari i saj ta detyrojë atë që të marrë atë që do ai. Përkundrazi, ai nuk ka të drejtë që ta martojë atë vetëm se me lejen e saj të qartë, që ta thotë me fjalë lejen nëse ka qënë e martuar më përpara, ngase ajo e ka provuar njëherë të paturit burrë, kështu që nuk ka turp që të thotë po ose jo.

Ndërsa, nëse është beqare, i mjafton asaj që lejen ta japë nëpërmjet heshtjes kur i kërkohet leja dhe duhet patjetër që t'i kërkohet leje; e nëse e fejon babai kur ajo është e vogël, para se të arrijë pjekurinë, ajo ka të drejtën që të zgjedhë, e nëse arrin pjekurinë e deklaron miratimin për atë burrë ose e e refuzon atë.

Ky është gjykimi i Islamit rreth martesës, ngase thotë i Dërguari, *alejhis-salaatu ues-selaam*:

لا تنكح الأيم حتى تستأمر. و لا تنكح البكر حتى تستأذن، و إذنها صمتها.

“Nuk martohet e veja derisa t'i merret mendimi, dhe nuk martohet beqarja derisa sa t'i merret leje, dhe leja e saj është heshtja e saj.”²²

Ose siç thotë ai, *alejhis-salaatu ues-selaam*, në transmetimin e Bukharit nga hadithi i Ebi Hurejrës, *radijAllahu anhu*.



²² E transmeton Bukhari (5136) dhe Muslimi (1419) nga hadithi i Ebi Hurejrës.

Trashëgimia e gruas në Islam

Janë përqëndruar ata që thërrasin në barazimin midis gruas dhe burrit në këtë pikë, sa që mund të mashtrohen shumë prej muslimaneve të shkujdesura, pasi ata ua kanë paraqitur atyre sikur Islami favorizon burrin më shumë se gruaja dhe i jep atij më shumë trashëgimi se gruaja, i jep atij sa për dy gra, pse?

Dhe ka disa përgjigje për këtë pyetje:

Ç'është e vërteta, Islami i jep burrit pjesë sa për dy gra dhe ky favorizim në trashëgimi nuk do të thotë se burri është i favorizuar ndaj gruas në të gjitha gjërat, siç do ta shohim më pas, inshaAllah.

Poashtu, kjo gjë nuk konsiderohet ulje e pozitës së gruas, përkundrazi kjo është një ndarje e drejtë.

Po sqarojmë atë që përmendëm më lart. Islami e ka ngarkuar burrin të vetëm që të shpenzojë për familjen e tij të përbërë nga gruaja dhe fëmijët, madje të shpenzojë edhe për çdo nevojtar nga të afërmit e tij; dhe nuk e ka ngarkuar gruan as që të shpenzojë për veten e saj dhe as për burrin e saj edhe nëse është më e pasur se burri i saj. Ndërsa përpara se të martohet shpenzimet e saj janë për familjen e saj.

Pra, a është prej drejtësisë që t'i jepet gruas për të cilën shpenzohet njësoj si ai që shpenzon për të?

Mendoj se gruaja e drejtë do ta parakalojë burrin në përgjigje duke thënë se: kjo nuk është drejtësi, edhe nëse ndodh.

Përkundrazi, drejtësi është ajo që ka bërë Islami, iu është dhënë drejtësi të dyve, edhe gruas edhe burrit.

Dhe lavdia e bujaria është e Allahut.



Udhëtimi i gruas në Islam

Çështja e dytë në të cilën janë përqëndruar ata që thërrasin në lirinë e barazinë midis burrit dhe gruas, është problemi i udhëtimit të gruas. Ata thonë:

“Islami nuk e lejon atë që të udhëtojë ashtu siç e lejon burrin, edhe pse udhëtimi mund të jenë kryerja e farzit të haxhit, pse?”

Dhe ajo që të çudit tek këta është se si e shtrembërojnë të vërtetën që t'i ngatërrojnë njerëzit. Kështu, ata e bëjnë paturpësinë ndershmëri dhe ndershmërinë paturpësi, ashtu siç po e bëjnë edhe me këtë çështje.

Dhe muslimania e paditur dëgjon çdo kënd që bërtet për shkak të injorancës së saj në çështjet e fesë së saj dhe ndonjëherë udhëhiqet edhe nga emocionet.

Dhe në realitet, Islami nuk e ndalon gruan nga udhëtimi i lejuar, por veçse e ka kushtëzuar udhëtimin e saj me një gjë të vetme, dhe ky kusht në të vërtetë është nderim dhe ruajtje e nderit të saj, veç sikur ta dinin.

Islami e kushtëzon udhëtimin e gruas me praninë e burrit të saj gjatë udhëtimit ose të dikujt prej të afërmeve të saj, me të cilët e ka haram martesën përgjithmonë, si babi, vëllai; sepse ata do të sakrifikojnë vetet e tyre për ta mbrojtur atë dhe nderin e saj dhe ujqërit do të përballen me trupat e tyre (të mahremëve të saj).

Po ashtu, ata i shërbejnë asaj gjatë udhëtimit për gjëra të cilat ajo nuk ka mundësi.

Dhe a e ka vënë Islami këtë kusht për gruan si poshtërim apo si nderim për të? Vërtet kjo është një nga fatkeqësitë më të mëdha!!

Le të logjikojë gruaja muslimane për përgjigjen e kësaj pyetjeje.

Ndërsa, Islami nuk e ndalon udhëtimin në vetvete.

Kështu, gruaja udhëton për haxh, udhëton për tregëti, udhëton për të vizituar të afërmit dhe njerëzit e saj, udhëton për të kërkuar dije dhe për arsye të tjera për aq kohë sa përmbushet kushti i cili është prania e burrit apo mahëremëve të saj.

Ky është gjykimi i Islamit në lidhje me udhëtimin e gruas o ju muslimanë, ngase Pejgamberi, *sallAllahu ‘alejhi ue sellem*, ka thënë:

لا يحل لامرأة تؤمن بالله و اليوم الآخر، أن تسافر مسيرة يوم
إلا و معها رجل ذو محرم عليها.

“Nuk i lejohet gruas që beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit që të udhëtojë për një ditë, përveçse duke qënë e shoqëruar nga një mashkull që është mahrem për të.”²³

Dhe ky hadith ka ardhur edhe me fjalë të tjera dhe në një numër transmetimesh dhe që të gjitha tregojnë se Islami e kushtëzon udhëtimin e gruas me praninë e burrit të saj ose të ndonjë prej meshkujve që janë mahremë për të dhe me të cilët i ndalohet martesë përgjithmonë.

Dhe kjo konsiderohet si nderim për gruan muslimane, veç sikur ta dinin.

Dhe prej Allahut vjen suksesi.



²³ Transmeton Bukhari (1088) dhe Muslimi (1339) nga hadithi i Ebu Hurejrës, *radijAllahu anhu*.

Qëndrimi i Islamit ndaj zbulimit të gruas, përzierjes dhe izolimit (të gruas me burrin e huaj)

Qëndrimi i Islamit ndaj këtyre çështjeve të Xhahilijetit (periudhës para-Islame) është i qartë dhe ai është një qëndrim i logjikshëm dhe i natyrshëm, madje është i pranueshëm nga ata që kanë prirje të shëndoshë. Dhe Islami me ashpërsi i refuzon këto aspekte të Xhahilijetit, sidomos izolimin e gruas dhe burrit vetëm për vetëm, ngase i Dërguari me Udhëzim, *alejhis-salaatu ues-selaam*, ka thënë:

أَلَا لَا يَخْلُونَ رَجُلًا بِامْرَأَةٍ إِلَّا كَانَ ثَالِثَهُمَا الشَّيْطَانُ.

“Sa herë qëndron një grua dhe një burrë vetëm për vetëm, veçse i treti mes tyre është shejtani”²⁴

لَا يَخْلُونَ أَحَدٌ بِامْرَأَةٍ إِلَّا مَعَ ذِي مَحْرَمٍ.

“Askush të mos qëndrojë vetëm për vetëm me një grua përveçse kur të jetë i pranishëm me të mahremi.”²⁵

Kështu pra thotë i Dërguari i Islamit o ju Muslimanë.

Dhe për ndalimin e aspektit tjetër itë injorancës që është zbulimi i bukurive të gruas, Allahu i Lartësuar thotë:

وَقَرْنَ فِي بُيُوتِكُنَّ وَلَا تَبَرَّجْنَ تَبَرُّجَ الْجَاهِلِيَّةِ الْأُولَىٰ

²⁴ Transmeton Tirmidhiu (2165) nga hadithi i Umerit, *radijAllahu anhu*, dhe e ka bërë sahih El-Albanij në *Sahihul Xhami'* (2546)

²⁵ Transmeton Bukhari (5233) dhe Muslimi (1341) nga hadithi i Ibn Abbasit, *radijAllahu anhu*.

“Qëndroni në shtëpitë tuaja e mos i zbuloni stolitë tuaja, ashtu si në Xhahilijetin e mëparshëm.”²⁶

Thotë duke iu drejtuar Pejgamberit të Tij dhe mikut të Tij, Muhammedit, *alejhis-salaatu ues-selaam*:

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ قُلْ لِأَزْوَاجِكَ وَبَنَاتِكَ وَنِسَاءِ الْمُؤْمِنِينَ يُدْنِينَ عَلَيْهِنَّ مِنْ جَلِيبِهِنَّ

“O Pejgamber, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit.”²⁷

Kështu e urdhëron Islami gruan muslimane, duke nisur me Nënat e Pastërta të besimtarëve e deri në kohën e njerëzve sot, madje deri kur Allahu ta shkatërrojë tokën dhe çka në të.

Islami e urdhëron gruan të ketë modesti, turp dhe të mos përzihet me burrat; sepse turpi është prej degëve të Imanit dhe i jep fund ketyre apsekteve të Xhahilijetit dhe e ashpëron refuzimin e tyre; sepse ato aspekte janë shkak për shthurjen morale nga e cila po u infektua shoqëria do të shkotërrohet dhe do të humbë. Dhe të vërtetën ka thënë poeti në thënien e tij:

*Vërtet, tek popujt morali është ai që ruhet,
E nëse morali lëshohet, çdo popull shuhet.*



²⁶ El-Ahzaab, 33

²⁷ El-Ahzaab, 59

Qëndrimi i Islamit ndaj punës së gruas

Ne nuk themi - siç pretendojnë - se gruaja nuk duhet të dalë nga shtëpia për të punuar. Përkundrazi, gruaja muslimane ka të drejtë të punojë dhe hapësirat e punës për të janë të gjera.

Dhe thënia se Islami e ndalon gruan nga puna është fyerje ndaj Islamit. Kam dëgjuar poashtu shprehjen se: mundësitë e saj për të punuar janë të pakta. Kjo thënie është e pashtjelluar, ngase gruaja muslimane ka të drejtën që të punojë pa qënë nevoja që të konkurrojë me burrat apo të përzihet me ta apo të qëndrojë vetëm me ta.

Gruaja ka të drejtën që të punësohet nëpër shkolla ose drejtoreshë ose sekretare në shkollat e vajzave, po ashtu ka të drejtë që të punojë mjeke, infermiere apo sekretare apo çdo lloj punë që gjen në spitalet e veçanta për gratë dhe punë të tjera të cilat i përshtaten asaj.

Ndërsa gruaja e cila del nga shtëpia me pretendimin se ajo do që të punojë - duke ia treguar bukurinë e saj të tjerëve - e zbukuruar, e parfumosur, moskokëçarëse, që dridhet e përdridhet dhe i sprovon të tjerët, ajo tamam sikur e ekspozon vetë veten e saj kur vërdalliset mes meshkujve.

Dhe gjykimi i Islamit për këtë është se ajo përngjason me zinaqaren, në sajë të transmetimit të saktë të Tirmidhiut nga hadithi i Ebi Musa El-Esh'arij, nga Pejgamberi, *alejhis-salaatu ues-selaam*, i cili ka thënë:

و المرأة إذا استعطرت فمرت بالمجلس فهي كذا و كذا، يعني زانية.

“Gruaja e cila parfumoset dhe kalon në një vendtubim njerëzish dhe ajo është kështu e ashtu, dmth: zinaqare.”²⁸

²⁸ Transmeton Ebi Daudi (4173) dhe Tirmidhiu (2786) dhe En-Nesaiu (5126) nga hadithi i Ebi Musa El-Esh'ari, *radijAllahu anhu*, dhe e ka deklaruar *sahih* dijetari i madh El-Albani në *Sahihul Xhami'*.

Thotë Tirmidhiu: ky hadith është i saktë. Edhe nga Ebi Hurejra është një hadith i ngjashëm me të tek Ebi Davudi dhe me sa duket ajo fjalë, dmth: “zinaqare”- tek thënia e Ebi Musa El-Eshariut është shpjegim i fjalës “kështu e ashtu” dhe Allahu e di më së miri.

Dhe shembulli i kësaj gruaje është si shembulli i ushqimit të shijshëm për të cilën gatuesi i saj ka vënë në lëvizje të gjitha aftësitë për ta përgatitur, pastaj e merr atë dhe e vendos në trotuar përmbri të cilit ndodhet një pellg me ujë të pistë dhe ia heq kapakun ushqimit e në të shkojnë insektet nga të gjitha vendet për të nuhatur aromën e saj, e kështu mizat qëndrojnë përreth saj dhe herë bien brenda dhe njerëzit po ashtu e shohin atë me fytyrë të vrenjtur e përbuzëse.

Dhe në fund mbetet ushqim për qentë nëse mbushet plot me insekte dhe s'ka dyshim që do të mbushet me insekte. Ky është shembulli i atyre që i zbulojnë bukuritë e tyre e që bredhin lartë e poshtë. Pra, le ta ngrejë veten e saj dhe nderin e saj gruaja Muslimane nga ky nivel i ultë dhe ta vendosë mbulesën e turpits mbi fytyrën e saj ashtu siç e ka urdhëruar Zoti i saj dhe kjo është më e mirë për të tek Allahu dhe tek shoqëria.

Me këtë, Islami kërkon që të mbrojë familjen Muslimane; sepse mirëqenia e saj është mirëqënie për shoqërinë, ashtu sikurse prishja e saj është prishje për të gjithë shoqërinë, siç u përmend më herët.

Vërtet Islami i ka kushtuar kujdes të madh kësaj çështjeje dhe ai nuk e neglizhon këtë ruajtje edhe në rastet e kryerjes së disa ibadeteve burra e gra bashkë në një vend, siç është për shembull tubimi në dy Bajramet. Pra, Islami e ka sistemuar mënyrën se si bëhet ky tubim për kryerjen e ibadetit.

Ka thënë i Dërguari i Udhëzimit, *alejhis-salaatu ues-selaam*, ndërkohë që po rregullonte safet:

خير صفوف الرجال أولها، وشرها آخرها،
و خير صفوف النساء آخرها، و شرها أولها.

“Safi më i mirë për burrat është safi i parë dhe më i keqi është safi i fundit; kurse safi më i mirë për gratë është safi i fundit dhe më i keqi është safi i parë.”²⁹

Dhe për shkak se ai, *sallallahu ‘alejhi ue sellem*, e dinte çfarë ndikimi ka gruaja e parfumosur në zemrën e burrit, e urdhëroi atë me thënien e tij:

إذا خرجت المرأة إلا المسجد فلتغسل من الطيب كما تغتسل من الجنابة.

“Nëse gruaja shkon e parfumosur në xhami, të lahët prej parfumit ashtu siç lahët prej *xhunubllëkut*.”³⁰

E më pas:

Ky hadith dhe ai që u përmend para këtij, konsiderohen me hak nga shembujt më të dalluar që i mbyll shtegun justifikimeve, ashtu siç edhe shihet.

Dhe Allahu është dhënësi i suksesit.



²⁹ Transmeton Muslimi (440) nga hadithi i Ebi Hurejrës, *radijAllahu anhu*.

³⁰ Transmeton En-Nesaiu (5127) nga hadithi i Ebi Hurejrës, *radijAllahu anhu*, dhe e ka deklaruar *sahih* dijetari i madh el-Albani në *Sahihul-Xhami*’ (503).

Fundi i jetës bashkëshortore

Merr fund jeta bashkëshortore me një nga keto dy ndarje:

- 1- Ndarja për shkak të vdekjes dhe kjo është diçka të cilën nuk e ka në dorë asnjë nga palët, ta shpejtojë apo ta vonojë atë, dhe prandaj nuk po flasim për këtë çështje.
- 2- Ndarja për shkak të divorcit dhe kjo është pika ku do të ndalemi për të diskutuar:

Konsiderohet divorci në këndvështrimin e Islamit si rrugëzgjidhje pasi janë shtuar mosmarrëveshjet dhe grindjet mes bashkëshortëve dhe ai është njësoj si damkosja me zjarr për të zgjidhur problemet bashkëshortore dhe damkosja me zjarr është kurimi i fundit.

Dhe fillon kurimi i mosmarrëveshjeve bashkëshortore me këto mënyra:

1- Mësimi dhe këshillimi:

Mësimi dhe këshillimi është ai i cili përfshin këshillimin, drejtimin dhe sqarimin se cilat janë të drejtat e burrit mbi gruan dhe në të kundërt, cilat janë të drejtat e gruas mbi burrin, si dhe përqëndrohet në sqarimin se cilat janë pasojat e humbjes së të drejtave të bashkëshortit dhe mosbindjes së tij.

2- Braktisja në shtat:

Braktisja është ajo e cila shkakton një lloj vetmie e izolimi dhe fton drejt pendimit dhe kthimit në bindje.

3- Rrahja:

Me kusht që të jetë vetëm rrahje edukuese e për t'i vënë frikën dhe jo rrahje për hakmarrje që shkakton dëmtim të lëkurës apo thyerje të kockave.

4- Të ulen të merren vesh e të diskutojnë:

Dhe merr pjesë në të një ndërmjetës nga njerëzit e tij dhe një ndërmjetës nga njerëzit e saj. E nëse nuk arrijnë gjë dhe secili nga të dy nuk e gjen mirë veten në jetën bashkëshortore, atëherë vjen divorci si shpëtimtar i kësaj situate duke i dhënë fund asaj jete e cila u kthye në skëterrë pasi që kishte qënë dashuri, mëshirë, qetësi e prehje.

Dhe këto stade të cilat i paraprijnë divorcit – dhe ndoshta e ndalojnë divorcin – i ka sqaruar sureja En-Nisa` në dy ajetet e mëposhtëme, ku thotë Zoti ynë i Gjithëlavdishëm:

الرِّجَالُ قَوَّامُونَ عَلَى النِّسَاءِ بِمَا فَضَّلَ اللَّهُ بَعْضَهُمْ عَلَى بَعْضٍ وَبِمَا أَنْفَقُوا مِنْ أَمْوَالِهِمْ ۚ فَالْصَّالِحَاتُ قَنِبَتْنَ حَافِظَاتٌ لِّلْغَيْبِ بِمَا حَفِظَ اللَّهُ ۚ وَالَّتِي تَخَافُونَ ذُشُورَهُنَّ ۚ فَعِظُوهُنَّ ۚ وَأَهْجُرُوهُنَّ فِي الْمَضَاجِعِ وَأَضْرِبُوهُنَّ ۚ فَإِنْ أَطَعْنَكُمْ فَلَا تَبْغُوا عَلَيْهِنَّ سَبِيلًا ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلِيمًا كَبِيرًا ﴿٢٨﴾ وَإِنْ خِفْتُمْ شِقَاقَ بَيْنِهِمَا فَابْعَثُوا حَكَمًا مِّنْ أَهْلِهِ ۚ وَحَكَمًا مِّنْ أَهْلِهَا ۚ إِنْ يُرِيدَا إِصْلَاحًا يُوَفِّقِ اللَّهُ بَيْنَهُمَا ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلِيمًا خَبِيرًا ﴿٢٩﴾

“Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi ato dhe, meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre. Gra të mira janë ato të dëgjueshmet, që ruajnë fshehtësitë që ka urdhëruar Allahu. Sa i përket grave që ju i druheni mosbindjes

dhe sjelljes së keqe nga ana e tyre, këshillojini, (e nëse kjo s'bën dobi) mos i pranoni në shtrat dhe (në fund) i rrihni ato (lehtas). Por, nëse ato ju binden, atëherë mos i ndëshkoni më. Allahu, me të vërtetë, është i Lartësuar dhe i Madhëruar! Nëse i druheni ndarjes midis burrit e gruas, atëherë caktoni një ndërmjetës nga ana e burrit dhe një nga ana e gruas. Në qoftë se ata dëshirojnë paqësim, Allahu sjell marrëveshje midis tyre. Allahu, me të vërtetë, është i Gjithëdijshtëm dhe i di të gjitha qëllimet.”³¹



³¹ En-Nisa, 34-35.

Përse Islami e ka lënë divorcin në dorën e burrit

U bë e qartë nga sa u përmend se lejueshmëria e divorcit është një çështje me rëndësi në këtë temë, nëse është vërtetuar se ai është ilaci i fundit për mosmarrëveshjet bashkëshortore.

Dhe mbetet këtu për t'u bërë një pyetje që ka shumë peshë nëse kuptohet përgjigja e saj ashtu siç duhet:

Përse është lënë divorci në dorën e burrit?

Gruaja nuk ka rol në divorc, përveçse në rastin kur ndarja bëhet me *khul'a*³² dhe kjo ndarje bëhet me ndërhyrjen e Gjykatës Sheriatike dhe nuk mund të veprojë gruaja si të dojë, siç edhe dihet.

Përgjigja për këtë pyetje është:

Përderisa burri është ai që duhet të paguajë gjobën e martesës, ai i cili jep mehrin dhe të gjitha shpenzimet e tjera, atëherë është lënë divorci në dorën e tij; ngase ai nuk do ta lërë pas dore jetën bashkëshortore për të cilën ka paguar gjobën për të formuar jetën bashkëshortore, përkundrazi ai do t'i kushtojë kujdes mbajtjes së qetësisë dhe harmonisë së institucionit të familjes sa herë që është e mundur.

E nëse do të lihej divorci në dorën e gruas ja se çfarë do të shohim: Do të shohim se një burrë ndërton një familje dhe e furnizon atë, pastaj kujdeset për arritjen e fryteve të shumëpritura nga ajo që themeloi. Më pas, shohim gruan- me logjikë e mendime të cekëta - e

³² **Shënim i përkthyesit:** *Khul'a* quhet ndarja që ndodh midis dy bashkëshortëve kur gruaja i paguan bashkëshortit diçka nga pasuria e saj që të marrë divorcin prej tij.

shkatërron familjen dhe e prish atë që ishte ndërtuar për arsye të parëndësishme; ngase ajo nuk ka paguar gjë për ndërtimin e saj, madje ndoshta heq dorë nga ajo që të provojë një tjetër.

Dhe unë mendoj se gruaja muslimane e drejtë më beson në ato që u përmendën më parë në lidhje me burrin; ngase disa të dhëna nga sjellja e disa grave dëshmojnë për atë që thamë në kohën kur divorci nuk është në dorën e saj. Dhe Allahu e di më së miri.

E më pas.

O vëllezër muslimanë:

Le ta zbatojmë Islamin tonë me vepra sa të kemi mundësi, e jo vetëm me fjalë, sepse Islami është fe e punës dhe e praktikës. Kështu, musliman do të thotë: njeri i nënshtruar, i dorëzuar urdhërave të Zotit dhe Krijuesit të tij dhe zbatues i gjykimeve të Tij.

Qëllimi i mirë, nijeti i sinqertë, puna e mirë dhe përpjekja për ta zbatuar Sheriatin, këto janë ato që sheh Zoti tek robërit e tij; ngase Pejgamberi i Udhëzimit, *alejhis-salaatu ues-selaam*, thotë:

أَنَّ اللَّهَ لَا يَنْظُرُ إِلَّا صُورَكُمْ وَ أَمْوَالَكُمْ وَلَكِنْ يَنْظُرُ إِلَّا قُلُوبَكُمْ وَ أَعْمَالَكُمْ.

“Vërtet Allahu nuk sheh në pamjet dhe pasuritë tuaja, por sheh zemrat dhe punët tuaja”³³

O ju vëllezër, vërtetë që ju keni mundësinë që të punoni për fenë tuaj, për Islamin tuaj, sepse ligji i vendit tuaj u lejon juve që t’i shërbeni lirisht fesë tuaj dhe duhet të dini se kjo liri është për ju

³³ Transmeton Muslimi (2564) nga hadithi i Ebi Hurejrës, *radijAllahu anhu*.

mirësi prej mirësive të Allahut dhe duhet ta shfrytëzoni atë duke punuar me seriozitet për të përhapur mësimet e Islamit tuaj.

Allahu është me ju nëqoftëse jeni të sinqertë në veprat tuaja ngase Ai, i Lartësuari, është me ata që punojnë e janë të sinqertë, u jep sukses dhe i udhëzon.



Përktheu: Umm 'Akil